Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Samire Sahiti	**24.11.2023**	**10.12.2023**	**2023/0937**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 24.11.2023, OE "PROGLOBAL SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0937, kundër njoftimit për anulimin të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Matja e hidrostatikes dhe rimbushja e aparateve kunder zjarrit" me nr. të prokurimit: "214-23-3593-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës 108,000.00 €. Ankesa është përseritur lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së (OSHP: 2023/0497). Më Nr. 2023/0937 i dt:24.11.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Rregullorja per Prokurim Publik 001/2022

- Neni 17 Dosja e Tenderit
- Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve Neni 97, i rregullores nr. 001/2022.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat që lidhen me pretendimet ankimore janë lidhur me specifikimin teknik, me këtë rast kemi anulim të aktiviteti të prokurimit me arsye specifikimi teknik.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

DEKLARATË

[të deklarohet komisioni vlerësues mbi arsyet që e mbështesin këtë rekomandim]

Komisioni i Ri-vlerësimit në bazë examinimit, vlerësimit dhe krahasimin të ofertave, ka konstatuar se për tenderin " Matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit", janë pranuar 3 (tre) Tender (oferta).

Me rastin e Ri-vlerësimit, komisioni profesional pas shqyrtimit të ofertave lidhur me kërkesat tjera për kualifikim, me qëllim të sqarimit të specifikave teknike dhe kushteve të realizimit të këtyre shërbimeve, e ka shqyrtuar kërkesën për inicim nga Njësia Kërkuese e cila kërkesë është bartur në Dosje të tenderit te ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME për këtë aktivitet të prokurimit dhe ka vërejtur se ka parregullsi në këto specifika teknike, në mes tjerash si psh:

16. Afati i kontratës do të parashihet të përfundoj brenda 36 muaj (3 vite), Faza e parë e trajtimit do të jete menjëherë me nënshkrim te kontratës, dhe e dyta dy (2) vite pas fazës së parë.

17. OE duhet të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të kontratës e cila do të realizohet në dy faza të rimbushjes përgjatë kontratës së nënshkruar.

Kjo kërkesë është në kundërshtim me Listën e çmimeve -Matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit, në të cilën kanë ofertuar Operatorët Ekonomik, sepse nga njësia kërkuese këtu është kërkuar matja dhe mbushja e të gjitha aparateve për një herë dhe nuk është cekur në këtë Listë (x 2) Matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit do të realizohet në dy faza të rimbushjes përgjatë kontratës së nënshkruar.

Pas kësaj situate dhe paqartësie, gjatë vlerësimit, komisioni i ri-vlerësimit e ka pa të nevojshme ta konsultojmë njësinë kërkuese të na japin sqarime, lidhur furnizimet dhe shërbimet që duhet të kryhen dhe nga ta kemi mare përgjigjeje si vijon:

Te nderuar, referuar anomalive te specifikuara ne përshkrimin e dosjes te tender dokumentit:

"Matja Hidristatike dhe Rimbushja e Aparateve Kundër Zjarrit"- propozoj anulimin e procedurave për arsye se sipas pikave ne specifikim :

Pika 1. Bie ne kundërshtim si përshkrim ku përmenden vetëm Aparatet me Pluhur . (nderimi I pluhurit ne aparate.) kurse ne tabelën e ndërtesave janë paraqitur aparatet për Fikjen e Zjarrit , - P-9 me pluhur

Pastaj P 9 L (Ujë) Si dhe CO2 gaz (për kg te ndryshëm) .

Gjithashtu Pika 3. Përmendet vetëm Pluhuri për mbushjen e aparateve kundër zjarrit ,

Askund nuk përmenden aparatet dhe nuk janë te specifikuar – përshkruar aparatet:

E mbushura me substanca te vendosura bocës:

ujë; gaz; shkumë; - përveç pluhurit me Pluhur

pika 4. Është e pa kuptueshme thotë:

çdo pajisje për fikjen e zjarrit duhet te jetë e testuar për shtypje (presion) te sigurt dhe ne pajtim me standardet origjinale te prodhuesit. – PRA NUK KUPTOHET A DUHET TE BEHET ATESTIMI I BOCES enës (e cila sipas procedurave behet nen presion – shtypjes lëngut.)

pika 7. Thotë : te gjitha aparatet për shuarjen e zjarrit duhet te jene te certifikuara sipas standardeve evropiane (Certifikatat te dorëzohen se bashku me Ofertën), mendoj se është e pa kuptimte ne nuk po kërkojmë blerjen e aparateve te RI.

Pika 16. Afati I kontratës do te parashihet te përfundoj 36 muaj (3 vite), Faza e pare e trajtimit do te jete menjëherë me nënshkrim te kontratës dhe e dyta dy (2) vite pas fazës se pare,

Pra nëse e ka kuptimin se ne do ti rimbushim Aparatet për fikjen e zjarrit ne fazën e pare q'ka parasheh faza e dyte ti rimbushim prape aparatet duke e larguar pluhurin ose gazin e mbushur para dy viteve????

Gjithashtu pika 17 . thotë OE duhet te filloj punën menjëherë pas nënshkrimit te kontratës e cila do te realizohet ne dy faza te rimbushjes përgjatë kontratës se nënshkruar.

Pra Brenda tri (3) viteve ti mbushim , ti zbrazim dhe prape ti mbushim Aparatet për Fikjen e zjarrit

Te nderuar, mendoj se këto pika bien ndesh me procedurat për trajtimin e Aparateve Kundër Zjarrit , sepse nuk parashihen ne asnjë standard dhe ligj nderimi I substancave ne Bocën e Aparateve Kundër Zjarrit çdo dy vite .

Afat ligjore sipas ligjit për Aparatet bartëse dhe lëvizëse për shuarjen e zjarreve duhet të kontrollohen çdo gjashtë (6) muaj.

Pas përgjigjëjes nga Njësia kërkuese, komisioni rekomandon Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit anulimin e kësaj procedure te prokurimit, sipas nenit 62, pika 1.1. te LPP-se i cili parasheh me sa vijon:

Arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik -pas hapjes së tenderëve:

Një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do të ndodh në proceduren e prokurimit, e cila nuk mund të

rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të Prokurimit.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Lidhur me këtë lëndë ka pasur ankesë dhe është trajtuar përmes vendimit OSHP: 2023/0497. Kjo lëndë është kthyer në rivlerësim përmes ketij vendimi. Ndërsa, pas rivlerësimit janë pretendime te tjera ankimore.

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **PROGLOBAL SH.P.K.**

Deklartë detale sipas OE ankues:

Me datën 10/11/2023, AK – MPB, ka publikuar formularin B58 – Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues sa i përket procedurës se prokurimit me titull "*Matja e Hidrostatikes dhe mbushja e aparateve kundër zjarrit*" me numër te prokurimit: **214-23- 3593-2-2-1,** ku procedura e prokurimit tentohet përsëri te anulohet, përkundër faktit se OSHP me vendimin e datës 24/08/2023, e ka obliguar AK-MPB, qe te bëje rivlerësim te ofertave bazuar ne kërkesat e përcaktuara ne Dosje te Tenderit dhe ne Njoftim për Kontrate.

OE ankues "PROGLOBAL"SHPK, bazuar ne dispozitat e nenit 108/A, te LPP-se e ka kundërshtuar propozimin për anulim, ka kërkuar qe te zbatohen dispozitat ligjore dhe urdhri nga OSHP-se. Kjo procedure e prokurimit eshte publikuar ne muajin prill te këtij viti dhe ende AK – MPB e prolongon përkundër faktit se OSHP, përmes vendimit ka konstatuar se AK – MPB, ka shkelur dispozitat ligjore.

Pretendimi ankimore 1.

Arsyetimi i anulimit te aktivitetit te prokurimit i potencuar ne letër standarde se:

"*Një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do te ndodhe ne procedure te prokurimit dhe se Komisioni Profesional pas shqyrtimit te ofertave ka shqyrtuar kërkesën për inicim nga njësia kërkuese, kërkese kjo e bartur ne aneksin 1 Specifikacioni i detyrueshëm ka parregullsi ne specifikat teknike*" përkatësisht arsyetimi se "***me listën e çmimeve – matja e hidrostatikes dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit është kërkuar matje dhe mbushje e te gjitha aparateve përnjëherë dhe nuk eshtë cekur ne këtë liste matja e hidrostatikes dhe mbushja e aparateve kundër zjarrit, se do te realizohet ne dy faza te rimbushjes përgjatë kontratës se nënshkruar***", ne fazën pas vlerësimit dhe rivlerësimit te ofertave, paraqet shkelje flagrante te dispozitave ligjore te nenit 62 te LPP-se dhe nenit 97, te Rregullores nr. 001/2022, për Prokurim Publik.

Përvec¸ kësaj, anulimi i aktivitetit te prokurimit ne këtë faze te prokurimit AK-ne – Zyrën e Prokurimit dhe komisionin rivlerësues te ofertave e implikon me shkelje te rende ligjore te përcaktuar me nenin 97 te Rregullores 001/2022 pika h) dhe k) ku përcaktojnë se: ***h. Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së.***

k) Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të

Prokurimit Publik.

Pretendimi ankimore 2.

AK – MPB, tani pas kërkesës për ri shqyrtim ne arsyetim te vendimit, përshkruan kërkesa te aneksit 1 te dosjes se tenderit pozicionin 16, ku eshtë përshkruar se Afati i kontratës do te parashihet qe te përfundoj brenda 36 muajve (3 vite).

Faza e pare e trajtimit do te jete menjëherë me nënshkrimin e kontratës dhe e dyta dy vite pas fazës se pare dhe pozicionin 17. OE-te duhet te fillojnë punën menjëherë pas nënshkrimit te kontratës e cila do te realizohet ne dy faza te rimbushjes përgjatë kontratës se nënshkruar.

Kjo qeshtje eshtë absurde arsyetimi i anulimit bie ndesh me nenin 62, te LPP-se.

Kjo procedurë e prokurimit eshtë publikuar me datën 13.04.2023, dhe AK ende nuk e prolongon e neglizhon procedurën përderisa arsyetohet ne faza dhe veprime përgjatë procesit te kohëzgjatjes se kontratës, përderisa pajisjet ekzistente dhe furnizimet mbeten pezull si rezultat i vet pezullimit te procedurës se prokurimit, ku rreziku është permanent nga veprimet apo mos veprimet te cilat i atribuohen zyrtareve përgjegjës te AK-se

Neni 17.12 i RRPP-se, përcakton:

Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në 1.

bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do te të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë. Veçanërisht, autoriteti kontraktues duhet të ketë parasysh, kur përgatitet dosja e tenderit, që mos të ketë komunikime, diskutime ose negocime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve.

Pra OE-te ne ketë faze te prokurimit apo edhe për teke te AK-se dhe zyrtareve te caktuar nuk mund ta pësojnë ne ketë faze, ku tani me është hera e trete qe neve si OE,

kërkojmë qe ti realizojmë te drejtat tona te garantuara me ligj dhe kjo gjë po vazhdon te na shkakton dëme morale dhe materiale, përfshirë hartimin e shkresave depozitën dhe bllokimin e mjeteve materiale dhe shumë çështje tjera.

Pretendimi ankimore 3.

Autoriteti Kontraktues, pas hapjes se ofertave, pas vlerësimit, pas ri vlerësimit dhe pas urdhrit te OSHP-se, nuk mund ta anuloj aktivitetin e prokurimit.

Procedura e prokurimit e iniciuar nga AK, ka te beje me kontrate publike kornize – 36 muaj apo 3 vjeçare dhe sipas nenit 38 te LPP-se, i trajton kontratat kornize dhe përqindjen e tyre, përkatësisht par. 2 përcakton qe:

2. "...Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë tridhjetë përqind (30%). pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht."

Prandaj AK, bazuar ne llojin e procedurës, është dashtë qe te veproj sipas dispozitës se larte përshkruar ligjore.

Aneksi 1 Specifikacionet Teknike te Detyrueshme eshtë i qarte se bashku me listën – përshkrimin e çmimeve ku eshtë përcaktuar se OE duhet te ofroje çmimin për dy trajtime te aparateve te zjarrit – matjen hidrostatike dhe rimbushjen AKZ, prandaj ne si OE edhe tek paramasa dhe parallogaria kemi ofruar çmimin për trajtim dy here i cili do te realizohet përgjatë gjithë vlefshmërisë se kontratës. AK, para publikimit te njoftimit për anulim te aktivitetit te prokurimit, kane mundur te kërkojne sqarim plotësim – DEKLARATE, nga OE, dhe te marrin konfirmim për përmbushjen e

tërësishme te kontratës dhe realizimin e pozicionit te përcaktuar ne aneksin 1, dhe te ofruar si çmim ne paramas dhe parallogari, ku ne si kompani edhe përmes kësaj kërkese për ri shqyrtim e konfirmojmë se realizmi i projektit do te realizohet sipas kërkesave – Specifikacioneve teknik te Detyrueshme me çmimin e ofruar ne paramase dhe parallogari.

Ne si OE e kemi kuptu dhe me vetedije te plote ne **Listen e cmimeve kemi ofertu me cmim per trajtimet per 2 here qe do te behen pergjate vlefshmerise se kontrates**, **Te konfirmuara dhe ne Kerkesen per Rishqyrtim dhe Deklaraten, date 14.11.2023**

Përgjigje në pretendimet:

AK e ka anuluar këtë aktivitet me vendimin e datës 10.11.2023 me arsyet si në vijim: "Ministria e Punëve të Brendshme në pajtueshmëri me Nenin 62 të LPP pika 1.1. Anulon Aktivitetin e Prokurimit. Arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit publik, pas hapjës së tenderëve.

1.1 Një shkelje e LPP-se ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund tërregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit;

Me rastin e ri-vlerësimit, komisioni profesional pas shqyrtimit të ofertave lidhur me kërkesat tjera për kualifikim, me qëllim të sqarimit të specifikave teknike dhe kushteve të realizimit të këtyre shërbimeve, e ka shqyrtuar kërkesën për inicim nga Njësia Kërkuese e cila kërkesë është bartur në Dosje të Tenderit te ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYTUSHME për këtë aktivitet të prokurimit dhe ka vërejtur se ka parregullsi në këto specifika teknik, të cilat edhe gjatë tenderimit nuk janë korrigjuar pasi nuk ka pasur kërkesë për sqarime nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës, në mes tjerash këto parregullsi janë si vijon:

16. Afati i kontratës do të parashihet të përfundoj brenda 36 muaj (3 vite), Faza e parë e trajntimit do të jetë menjëherë me nënshkrim te kontratës, dhe e dyta dy (2) vite pas fazës së parë.

17. OE duhet të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të kontratës e cila do të realizohet në dy faza të rimbushjes përgjatë kontratës së nënshkruar.

Kjo kërkesë është në kundërshtim me Listën e çmimeve- Matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit, në të cilën kanë ofertuar Operatorët Ekonomik, sepse nga njësia

kërkuese këtu është kërkuar matja dhe mbushja e të gjitha aparateve për një herë dhe nuk është cekur në këtë listë Matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit do të realizohet në dy faza të rimbushjes përgjatë kontratës së nënshkruar. Me rastin e kryerjes së shërbimit-Matja e hidrostatikës dhe rimbushja e aparateve kundër zjarrit, kryhet sasia dhe nuk mbetet për fazën e dytë ti rimbushim prap aparatet.

Pas kësaj situate dhe paqartësie, gjatë vlerësimit, komisioni i ri-vlerësimit e ka pa të nevojshme ta konsultojmë njësinë kërkuese të na japin sqarime, lidhur furnizimet dhe shërbimet që duhet të kryhen dhe nga ta kemi mare përgjigjeje se me ratin e përgatitjes së specifikave teknike janë gabime te shumta teknike, të cilat **cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, kurse gjatë realizimit të kontratës krijojnë parregullsi ligjore të nuk munden të tejkalohen".**

Përgjigje: Specifikimi teknik sipas aneksit 1 të kësaj dosje është i detyshueshem dhe si i tillë duhet të respektohet, ndërsa te lista e cmimeve nuk specifikohet se sa herë duhet të kryhet një shërbim i caktuar, por është e specifikuar në ankesin 1 dhe OE nuk ka shprehur shqetësim lidhur më këtë por e ka marrë si te kuptueshëm dhe ka ofertuar mbi bazën e specifikimit teknik sic deklaron. E meqë në këtë fazë nuk ka mundësi të këtë korigjime apo përmisime. Andaj, për të qartësuar këtë situatë do të ishte me e arsyshme një informatë shtesë e kërkuar nga AK drejtë OE-ve, për të vërtetuar nëse është kuptuar ashtu sic ka qenë i menduar realizimi i këtij projekti.

Meqë, lënda është mjaftë e ndjeshme dhe komplekese sqarimet ndërmjetë AK dhe OE do të ishin të nevojshme, për të evituar situata jo të mirë, qoftë gjatë zbatimit apo edhe me anulim kësaj procedure, e cila është kontratë publike kornize që rregullohet me neni 38 të LPP-së.

Ndësa, sa i përketë pretendimit se nuk është respektuar vendimi i OSHP-së, nuk qendron pasi AK ka kthyer lëndën në rivlerësim, por gjatë rivlerësimit sipas komisionit janë konstatuar mos përputhje apo gabime teknike ndërmjetë Listës se cmimve dhe Aneksit 1 Specifikimit Teknik ie të cilët ka rekomanduar për anulim.

Andaj, bazuar në këto i propozojmë panelit shqyrtues që ankesa të merrët pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim në menyrë që të qartësohet situata e krijuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **PROGLOBAL SH.P.K.**

Samire Sahiti